

Komuniteti ndërkombëtar dhe ish-Republika e Jugosllavisë (3)

Bashkimi Sovjetik në veprim për ruajtjen e Jugosllavisë

Në fillim të korrikut 1991, Ministria sovjetike e Punëve të Jashtme ua kishte dërguar një paralajmërim të gjithë fqinjëve të Jugosllavisë Bullgarisë, Hungarisë, Shqipërisë dhe Austrisë në të cilin i këshillonte që të mos e përdorin krizën e Jugosllavisë dhe të ndalin të gjitha aktivitetet me të cilat do të përpiqeshin që të realizonin pretendimet territoriale ndaj Jugosllavisë

Duke iu referuar vendimit nga takimi i fundit i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Hans Dietrich Genscher gjithashtu kishte kërkuar prej Qeverisë jugosllave që të vendosë kontroll mbi forcat e parregullta të armatosura. Thelb i demarshit të Gencherit sidoqoftë ishin dy fjali që e rrisnin kërcënimin e njohjes: "Nëse gjakderdhja vazhdon, dhe politika e faktit të kryer nga forcat e përkrahura prej ushtrisë jugosllave nuk ndalen menjëherë, Qeveria Federale e Gjermanisë duhet seriozisht të mendojë për njohjen e Kroacisë dhe Sllovenisë në kufijtë e tyre. Gjithashtu do të marrë pjesë në shqyrtimin korrespondues me komunitetin evropian". Dhe derisa serbët nuk u dorëzuan dhe dhuna vazhonte, Gjermania vazhdoi të bëjë presion te komuniteti evropian që të ndërmarre hapa.

Derisa Gjermania me hezitim e mbështeste pavarësinë e Sllovenisë dhe të Kroacisë, Bashkimi Sovjetik dëshironte që Jugosllavia të ruhet me çdo çmim. Bashkimi Sovjetik kishte shprehur pikëpamjet e veta në një letër të datës 4 gusht 1991 drejtuar Organizatës për Siguri dhe

Bashkëpunim në Evropë (OSBE), në të cilën e kritikonte komunitetin evropian se nuk ka bërë çdo gjë për të zgjidhur krizën jugosllave.

Politika e Bashkimit Sovjetik ndaj Jugosllavisë bazohej në një miqësi historike mes rusëve dhe serbëve. Gjithashtu feja ortodokse i lidhte rusët me serbët, sikur që i kishte lidhur edhe grekët. Edhe gjatë periudhës së parë të krizës jugosllave, Bashkimi Sovjetik gjithashtu kishte pasur përvojë të lëvizjeve për pavarësi dhe shpalljes së pavarësisë nga ana e disa republikave sovjetike, sidomos në vendet baltike, prandaj ishte i interesuar që Jugosllavia të mbetej unike. Ministri i Jashtëm sovjetik, Alexander Alexandrovich Bessmertnyh, kishte deklaruar qysh në prill të vitit 1991 se ruajtja e integritetit territorial të Jugosllavisë është "një nga parakushtet për stabilitet në Evropë".

Në fillim të korrikut 1991, Ministria sovjetike e Punëve të Jashtme ua kishte dërguar një paralajmërim të gjithë fqinjëve të Jugosllavisë në të cilin i këshillonte që të mos e përdorin krizën e Jugosllavisë dhe të ndalin të gjitha aktivitetet me të

cilat do të përpiqeshin që të realizonin pretendimet e kahmotshme territoriale ndaj Jugosllavisë dhe e kishte kërkuar këtë gjë nga Bullgaria, Hungaria, Shqipëria dhe Austria. Thënë ndryshe, ata duhet të përmbaheshin nga përdorimi i lëvizjeve secesioniste brenda Jugosllavisë për të kënaqur interesat e tyre kombëtare.

Ambasadorët sovjetikë në vendet fqinje të Jugosllavisë ishin udhëzuar që të bëjnë çfarëdo që mundën për të përcjellë mesazhin se Bashkimi Sovjetik e përkrah ruajtjen e Jugosllavisë.

Është me rëndësi të theksohet megjithatë se pavarësisht faktit se Bashkimi Sovjetik i kishte dërguar mesazh komunitetit ndërkombëtar se nuk do të qëndrojë pasive duke parë shpërbërjen e Jugosllavisë, posaçërisht nënien në veprim të intervenimeve të jashtme, lidhshipi politik sovjetik vendosi se do të ndihmonte Jugosllavisë vetëm politikisht dhe atë nëpërmjet institucioneve ndërkombëtare, dhe jo me ushtri.

Zv.ministri i Jashtëm sovjetik atëbotë, Julij Mikhaïlovich Kwizinskiy, bile kishte thënë se për shkak të problemeve të brend-



Ushtarë të Armatës Popullore të Jugosllavisë pas një beteje në terren. Autostrada e Beogradit 1991

shme ekonomike dhe politike, prioriteti absolut në politikën e jashtme të Bashkimit Sovjetik ishte që të ketë marrëdhënie të mira me SHBA-në, Evropën Perëndimore, dhe Gjermaninë në veçanti. Të gjitha të tjerat ishin më pak të rëndësishme. Dhe qëndrimi i tillë i Bashkimit Sovjetik i kishte zhgënjyer politikanët serbë dhe udhëheqësit proserbë të Armatës Popullore Jugosllave (JNA).

Sipas Ministrit jugosllav të Mbrojtjes, gjeneralit Veljko Kadijeviq, SHBA-ja dëshironte që të ndryshonte regjimin dhe sistemin socio-politik në Jugosllavi. Vlerësimi i situatës nga Kadijeviq dhe Joviqi ishte se shkatërrimi i Federatës Jugosllave me politikën "e fakteve të kryera", (deklaratave të pavarësisë së Sllovenisë dhe Kroacisë, rebelimit të shqiptarëve në Kosovë, etj.) dhe veprime të tjera kundër Kushtetutës do të çonte në një luftë civile dhe ndërhyrjen direkte ushtarake nga

të huajt. E tëra kjo, sipas tyre, ishte pjesë e një plani unik për shkatërrimin e Jugosllavisë si një vend i pavarur dhe unitar. Liderët politikë serbë dhe shumica e oficerëve të ushtrisë jugosllave ende insistonin në doktrinën e tyre për rrezikun nga "Armiku i jashtëm" që ishte zhvilluar në Jugosllavinë socialiste pas Luftës së Dytë Botërore. Të gjithë qytetarët e Jugosllavisë duhet që të ishin "të kujdesshëm dhe të shikonin aksionet e armiqve të jashtëm, të cilët dëshironin që të ndërronin sistemin politik në Jugosllavi ose të cilët punonin për shpërbërjen e Jugosllavisë".

(vijon)

Studimi "Komuniteti ndërkombëtar dhe ish-Republika e Jugosllavisë" është përpiluar nga një grup punues prej 20 ekspertësh të ndryshëm ndërkombëtarë dhe nga trevat e ish-Jugosllavisë. Udhëheqës të studimit kanë qenë Matjaz Klemençiq dhe Dushan Janjiq.

"Rekuiem për një kampion: historia e Mike Tysonit" (11)

Mbani mend - po vjen Tysoni

Në raundin e tretë hyn rrufeshëm. Qëllon nja dy-tri herë. Pastaj Holyfieldi i shmanget rrahjes së drejtpërdrejtë duke e kapur Tysonin në klinç. Përnjëherë bota e sheh atë që nuk kishte pritur. Mike Tyson në klinç ia kafshon veshin kundërshtarit. Arbitri ia merr një pikë Tysonit. Në këndin e Holyfieldit nisin ankesat. Kërkohej diskualifikimi

Mike Tyson i kishte kthyer dy nga tre titujt e kampionit të botës në kategorinë e rëndë në boks. Me titujt e WBC dhe WBA në xhep, Mike Tyson po e ndiqte edhe titullin e tretë, atë të IBF-së. Mirëpo, para kësaj e kishte një hesap të vjetër për ta larë. Më

1991, para se të arrestohej, e kishte pasur një meç të aranzhuar kundër njëfarë Evander Holyfieldit dhe tani Tyson dëshironte që të rrahej më në fund me këtë boksier. Holyfieldin e kishte për hatër, sepse pikërisht ai e kishte nokautuar James Buster Douglasin, njeriun e vetëm që e kishte rrahur Tysonin.

Holyfieldi në karrierë i kishte zhvilluar 26 meçe, prej të cilave i kishte fituar 25. Mirëpo, ai e kishte një telash. Zemrën. Mjekët thoshin se "zemra e tij është një plumb i shpenzuar".

Ndërsa boksierët po bëheshin gati për duelin e tyre në Las Vegas, më 9 nëntor, mijëra njerëz po lidhnin bast nëpër bastore për Holyfieldin. Miliona të tjerë po e vënin bastin e tyre në emër të Mike Tysonit. Gati të gjithë gazetarët kishin shkruar

se prisnin që Tyson ta shënonte edhe një fitore të re. Derisa raundi i parë po vazhonte, të gjithë ata doli se kishin pasur të drejtë. Pjesërisht. Mike Tyson e qëlloi Holyfieldin me një të djathtë shkatërruese, por muskulozi e duroi goditjen. Madje, nisi edhe ta kthente ndonjë goditje aty-këtu. Pastaj edhe ndonjë tjetër. Derisa në fund e mori iniciativën.

Mike Tyson nuk po mund ta qëllonte me aq forcë kundërshtarin e tij. Po nervozohej. Po hidhërohej me vetveten. Deri në raundin njëmbëdhjetë. Pastaj ai u rrëzua. Jo Holyfieldi. Tysoni. Mediat raportuan se kjo kishte qenë befasia më e madhe e vitit. Evander Holyfield nuk pajtohej me ta. Ai konsideronte se kurdoherë mund ta rrahte Mike Tysonin, njeriun më të tmerrshëm të planetit.

Për Mike Tysonin ishin vetëm dy ngushëllime. Tridhjetë milionë dollarë që thoshin se i kishte fituar pas këtij dueli dhe një grua që i rrinte pranë e që quhej Monica Turner. Monica do të lindte së

shpejti Tysonit vajzën Reynan dhe të birin Amirin.

Tyson e kishte gjetur një prehje të lehtë me femijët e tij. Por ende donte të merrte hak ndaj Holyfieldit. Meçi i ardhshëm u caktua për 28 qershor 1997.

Këtë herë turma ishte në anën e Holyfieldit. Emri tij brohoritej në sallë. Mirëpo, Tyson këtë herë ishte më i përgatitur. Holyfield nuk po mund ta qëllonte dot kundërshtarin. Në raundin e parë e qëllon nën brez. Në raundin e dytë e qëllon me kokë. Nga arkada e Tysonit nis të rrjedhë gjak.

Tyson duket i nervozuar derisa në pushim para raundit të tretë po ia pastronin gjakun. Në raundin e tretë hyn rrufeshëm. Qëllon nja dy-tri herë. Pastaj Holyfield i shmanget rrahjes së drejtpërdrejtë duke e kapur Tysonin në klinç. Përnjëherë bota e sheh atë që nuk kishte pritur. Mike Tyson në klinç ia kafshon veshin rivalit. Arbitri ia merr një pikë Tysonit. Në këndin e Holyfieldit nisin ankesat. Arbitri lejon që dueli të vazhonte. Ankesat nuk ndalen. Mu atëherë Mike Tyson e kafshon


edhe një herë veshin e kundërshtarit. Këtë herë ia këput një copë fare.

Arbitri këtë herë e ndërpret meçin duke e diskualifikuar Tysonin. Ndërkohë, ndonëse meçi kishte përfunduar dhe mjekët po ia jepnin ndihmën e parë Holyfieldit, Tyson përpiqet t'i qerojë hesapet privatisht me kundërshtarin e tij. Ndërhyjnë punëtorët e sigurimit. Shumë punëtorë të sigurimit.

Pak minuta më pas, kur turma ishte larguar dhe ringu ishte zbratur, një pastrues e gjen copën e këputur të veshit të Holyfieldit. Boksieri i nënshtrohet operacionit. Mjekët amerikanë e bëjnë të pamundurën për t'ia ngjitur copëzën e kafshuar.

Mike Tyson, ndërkohë, ndëshkohet, me 3 milionë dollarë gjobë dhe me ndalesë për të boksuar. Ai arsyetohet.

"Holyfield bënte hile. Më qëlloi me kokë. Shiko çka m'i ka bërë fytyrës. Femijët po tmerrohen kur po më shohin". Për një vit e gjysmë Mike Tysonit i ndalohet të boksojë. Pastaj ai i kthehet sërisht ringut. Më 16 janar të vitit 1999, e nokauton Francois Bothan në raundin e pestë, pastaj më 23 tetor Orlin Norrisin në raundin e parë, më 2000 i nokauton Julius Francisin (raundi 2), Lou Savaresen (raundi 1) dhe Andrew Golothan (raundi 1) dhe më 13 tetor 2001 i del në mejdan Brian Nielsen në Danimarkës, të cilin e rrëzon në raundin e shtatë. Megjithatë, emri i tij kishte marrë një njollë të pahij-



jshme. Ndërkohë, ai sërisht, për të tretën herë, dëshironte titullin e kampionit. Mirëpo, tani titullin e mbante dikush tjetër. Një boksier i quajtur Lennox Lewis.

Ai ishte i gatshëm për Mike Tysonin. Mike Tyson ishte i gatshëm për pension.

(Në numrin e ardhshëm: Çfarë ishte fundi i karrierës së Tysonit? Cilat ishin fajet e reja të tij?)